



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Rr.Ibrahim Rugova, Nr.4, Tiranë, Shqipëri, T/F.+355-4-2281650 E. [info@cec.org.al](mailto:info@cec.org.al), [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)

### SYGJERIME PËR PËRMIRËSIME NË KODIN ZGJEDHOR

Raporti i OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet vendore 2015, krahas vlerësimit të procesit zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së, obligimet e tjera ndërkombëtare dhe standartet demokratike për zgjedhjet, si dhe me legjislacionin kombëtar, adresoi ndër rekomandimet prioritare "Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet në mënyrë që të eliminohen mangësitë dhe paqartësitë e identifikuara në këtë raport dhe ato të mëparëshme të OSBE/ ODIHR-it".

KQZ, në vlerësim të këtij rekomandimi, të eksperiencës institucionale, të angazhimit të vijueshëm institucional për rritjen e standarteve të proceseve zgjedhore, kërkon vëmendjen dhe vlerësimin e Kuvendit të Shqipërisë për ndryshime në Kodin Zgjedhor me qasje:

#### **I. Rritjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit të komisionerëve zgjedhorë të nivelit të dytë dhe të tretë.**

*"Duhet të merret parasysh rritja e pavarësisë, paanshmërisë dhe kapacitetit profesional të komisioneve zgjedhore. Ligji mund të ndryshohet për të lejuar për komisionerët zgjedhorë jo-partiake të të gjitha niveleve depolitizimin e administratës zgjedhore. KQZ-ja, duhet në mënyrë të paanshme të zbatojë cdo gjërmë dhe frymë të ligjit. Kapaciteti i sekretariatit të KQZ-së duhet të forcohet për të siguruar shkëmbimin efektiv të informacionit thelbësor brenda administratës zgjedhore". Rekomandimi nr. 1 i Raportit të OSCE/ODHIR për zgjedhjet lokale 2015.*

Pas publikimit të raportit të OSCE/ODIHR-it për zgjedhjet lokale 2015, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë, janë organizuar tre tryeza, ku fokusi kryesor i diskutimeve ishte forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit të trupave zgjedhore. Gjetjet dhe përfundimet e këtyre tryezave nxorrën dy rekomandime të rëndësishme:

1. Departizimi i trupave zgjedhore, arrihet si me forcimin e ligjit zgjedhor, me qëllim krijimin e mekanizmave efikasë ligjorë që do t'i pamundësonin partive politike të keqpërdornin kompetencat e gjëra që Kodi Zgjedhor i njeh, ose me ndryshimin e formulës për përbërjen e tyre.

2. Rritja dhe konsolidimi i profesionalizmit të administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, arrihet nëpërmjet krijimit të një Qendre Trajnimi Zgjedhor dhe Edukimit të Shtetasve.

3. Për sa i takon rekomandimit për forcimin e sekretariatit (nacion jo ligjor dhe i pa ndeshur më parë) KQZ ka dhënë një mendim të konsolidur se ky bashkëpunim me administratën zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, arrihet nëpërmjet ngritjes së 90 zyrave zgjedhore të përhershme në bashkitë e vendit, ku do të punësohen personel i rekrutuar nga KQZ (jo partiak) sipas kriterëve të mirëpërcaktuara, të cilët fare mirë mund të jenë në rolin e Sekretarit të KZAZ-ve.

## **II. Përkufizimin e aktit normativ dhe akteve që KQZ duhet të miratojë vetëm me shumicë të cilësuar, sipas përkufizimeve të zbatueshme në Ligjin për Gjykatat Administrative (Rekomandim i patrajtuar i Raportit të OSCE-ODHIR të vitit 2013).**

Në zgjedhjet për Kuvendin 2013, si dhe në zgjedhjet vendore 2015, miratimi i akteve të caktuara është shoqëruar me debate dhe mosmarrveshje të vazhdueshme sa i përket llojit të aktit, normativ apo individual, mosmarrveshje të cilat dhe Kolegji Zgjedhor i ka zgjidhur në mënyra të ndryshme, duke mos arritur as në unifikimin e praktikës gjyqësore.

Për trajtimin e këtij rekomandimi, i cili do të shmangte debate të gjata, mosmarrëveshje, ankime në Kolegjin Zgjedhor, **KQZ propozon që neni 23 i Kodit i Kodit Zgjedhor, në pikën 4 të tij, të ndryshojë si më poshtë:**

| <b>Është</b>  | <b>Propozohet:</b>  |
|---|---|
| Neni 23, pika 4<br><br>"4.Aktet normative të KQZ-së kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull për të gjitha zgjedhjet. Këto akte rishikohen në rast të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e tyre. Aktet për përgatitjen e zgjedhjeve si rregull miratohen apo ndryshohen jo më vonë se 60 ditë nga data e zgjedhjeve." | Neni 23, pika 4<br><br>"4. Aktet normative të KQZ-së janë në përputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Këto akte kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull për të gjitha zgjedhjet, dhe rishikohen vetëm në rast të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e tyre. Aktet për përgatitjen e zgjedhjeve si rregull miratohen apo ndryshohen jo më vonë se 60 ditë nga data e zgjedhjeve". |

**III. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, dispozitat përkatëse të përfshijnë çështjet që kanë të drejtë për të apeluar, afatet për gjykimin e ankesat, dhe juridiksioni i listës së zgjedhësve dhe ankesat lidhur me fushatën. (Rekomandimi nr.3 i Raportit të OSCE/ ODIHR për zgjedhjet e 21 qershorit 2015).**

1. Saktësimi i përkufizimit subjekt zgjedhor

Zgjedhjet vendore të 21 qershorit 2015, evidentuan mosmarrëveshje të cilat gjeneruan falë përkufizimit të ndryshëm që Kodi Zgjedhor i bën në dy dispozita (neni 2/20 dhe neni 63/1), nocionit "subjekt zgjedhor" .

E drejta e ankimit lidhet me interesin e ligjshëm, dhe në një proces zgjedhor interes të ligjshëm kanë pikërisht çdo subjekt zgjedhor dhe individëve apo partive/koalicioneve të cilëve u refuzohet kërkesa për tu regjistruar si subjekt zgjedhor.

Përkufizimi i unifikuar i përcaktimeve të nenit 2/20 dhe nenin 63 të Kodit Zgjedhor, propozohet si më poshtë.

| <b>Është</b>   | <b>Bëhet :</b>   |
|--|--|
| <b>Neni 63, pika 1</b><br>Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod. | <b>Neni 63, pika 1</b><br><b>Subjekte zgjedhore janë partitë politike, koalicionet zgjedhore, dhe kandidatët për kryetar në organet e njësisë së qeverisjes vendore.</b> |

2.Saktësimi i përcaktimit të afatit për shqyrtimin e ankimeve para zgjedhore.

Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, nenit 143, pika 4 dhe nenit 131, pika 2, evidentohet mosrakordim i afateve për shqyrtimin e ankimeve. Gjatë shqyrtimit të kërkesave ankimore para datës së zgjedhjeve, në rastet kur KQZ, në zbatim të nenit 135, pika 6 gjatë shqyrtimit në themel të çëshjes, ka kërkuar marrjen e provave nga të tretët, nuk ka qenë e mundur të respektohet afati dy ditor i shqyrtimit, përcaktuar në nenin 143/4. Nga 23 kërkesat ankimore para zgjedhore, për 5 prej tyre KQZ tejkaloi afatin e shqyrtimit (me tepër se dy ditë) për shkak se u nevojiti marrja e provave nga të tretët.

Për sa më sipër, afati për përfundimin e shqyrtimit të ankimit duhet të rishikohet, në vlerësim të rasteve kur KQZ vendos marrjen së provave nga të tretët për nevoja të hetimit administrativ.

| <b>Është</b>   | <b>Propozohet:</b>  |
|--|---|
| Neni 143, pika 3<br><br>"3. KQZ-ja merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve, jo më vonë se 10 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KQZ-ja merr vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit." | Neni 143, pika 3<br><br>3. KQZ-ja merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve, jo më vonë se 10 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KQZ-ja merr vendim jo më vonë se tre ditë nga paraqitja e ankimit. |

#### **IV. Detajimin e rregullave për regjistrimin e kandidatëve, duke përfshirë procedurat për mbledhjen, verifikimin, dhe vlefshmërinë e firmave mbështetëse.**

*"Rregullat për regjistrimin e kandidatëve, duke përfshirë procedurat për mbledhjen, verifikimin, dhe vlefshmërinë e firmave mbështetëse, duhet të jenë të qarta dhe të rregulluara mjaftueshëm para zgjedhjeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe siguri ligjore".*  
Rekomandimi nr.11 i Raportit të OSCE/ODIHR 2015.

1.Në lidhje me rregullat e verifikimit të listave mbështetëse të subjekteve zgjedhore, të cilat nuk zotërojnë mandat në kuvend apo në organet e qeverisjes vendore, saktësimi i procedurës nëpërmjet një ndryshimi në nenin 71 të Kodit Zgjedhor, është i nevojshëm, nevojë të cilën edhe rekomandimi e përmend. Verifikimi i firmave mbështetëse që subjektet zgjedhore paraqesin për të kryer procedurat e regjistrimit (për rastet kur nuk zotërojnë mandat), bëhet nga administrata e KQZ-së apo/dhe nga KZAZ-të. Propozimi konsiston në shtrirjen e parregullsive të dala nga verifikimi i 5% të nënshkrimeve në të gjithë listën e nënshkrimeve. Në këtë rast, do të kishim ndryshimin e nenit 71 të Kodit Zgjedhor si më poshtë:

| <b>Eshtë:</b>  | <b>Propozohet:</b>   |
|--|--|
| <b>Neni 71, pika 3</b><br><br>"3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, | <b>Neni 71, pika 3</b><br><br>"3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me |

|  |   |
|--|---|
| <p>nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi.”</p> | <p>vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.”</p>   |
|  | <p><b>Neni 71, të shtohet pika 4:</b></p> <p>“4.Rezultati i dalë nga verifikimi i 5 për qindshit të listës mbështetëse shtrihet në të gjithë listën mbështetëse. Numri i nënshkrimeve të parregullta pjestohet me numrin që përfaqëson 5 për qind të të gjithë nënshkrimevë të paraqitura. Numri që del nga ky pjestim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të parregullta në listën e paraqitur”.</p> |
|  | <p><b>Neni 71, të shtohet pika 5:</b></p> <p>“5.Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi.”</p>           |

2. Refereuar problematikës së shfaqur kur, gjatë shqyrtimit të kërkesave ankimore për rregjistrimin e listave shumëemërore dhe kandidatëve për kryetar, të partive të cilat nuk zotëronin mandat apo të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, listat me nënshkrimet mbështetëse të këtyre subjekteve rezultuan në disa raste me nënshkrime të bëra nga e njëjta dorë, (një person nënshkruan dhe në emër të personave të tjerë në listë.) lind pyetja, si duhet të vlerësohet i gjithë ky dokumentacion? (lista me nënshkrimet e zgjedhësve që mbështetin kandidatin/listën shumëemërore). A mund të konsiderohet e vlefshme lista me nënshkrimet mbështetëse e depozituar nga kandidati/partia nëse rezulton se ka nënshkrime nga e njëjta dorë, qoftë kjo dhe kur numri i nënshkrime të rregullta është në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Ky rast do të klasifikohet si parregullsi, e lokalizuar vetëm në ato raste, apo do të ketë një trajtim të veçantë në raport me vlefshmërinë e të gjithë listës mbështetëse të zgjedhësve.

#### **V. Përcaktimin e rregullave për rastin e dorëheqjes së kandidatëve të regjistruar.**

*“Vendimet në lidhje me regjistrimin e kandidatëve duhet të merren para fillimit të fushatës për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë garuesit. Kodi Zgjedhor duhet të përfshijë dispozitat lidhur me kohën dhe kushtet për tërheqjen e kandidatëve të regjistruar. Masa mbrojtëse duhen vendosur për të siguruar që të mos abuzohet me tërheqjen e kandidatëve”.*

*Rekomandimi nr.12 i Raportit të OSCE/ODIHR për zgjedhjet vendore 2015.*

KQZ në analizë teknike të procedurave për përgatitjen e bazës materiale zgjedhore veçanërisht të prodhimit të fletës së votimit (rekomandim dhe në raportin e OSBE/ODIHR 2011) paraqet propozimin konkret në zbatim të këtij rekomandimi duke konsideruar si afatin e fundit për rregjistrimin përfundimtar të kandidatëve 25 ditë para datës së zgjedhjeve si më poshtë:

1. Një kandidat i regjistruar mund të japë dorëheqjen jo më vonë se 24 orë pas vendimit të regjistrimit, por në çdo rast jo më vonë se 39 ditë para datës së zgjedhjeve. Dorëheqja konsiderohet si një veprim juridik i njëanëshëm, pranohet pa votim nga komisioni zgjedhor përkatës.
2. Një parti politike ose koalicion zgjedhor mund të kërkojë zëvendësimin e kandidatit të regjistruar nga komisioni zgjedhor përkatës, jo më vonë se 24 orë pas vendimit të regjistrimit, por në çdo rast jo më vonë se 39 ditë para datës së zgjedhjeve. Tërheqja e kandidatit nga partia politike/koalicioni zgjedhor, konsiderohet si një veprim juridik i njëanëshëm, pranohet pa votim nga komisioni zgjedhor përkatës.
3. Subjekti zgjedhor mund të depozitojë kërkesën për rregjistrimin e kandidatit zëvendësues, jo më vonë se 48 orë nga vdekja e kandidatit të regjistruar më parë, por jo më vonë se 37 ditë para datës së zgjedhjeve.

4. Në rast se kandidati i regjistruar vdes 37 ditë përpara datës së zgjedhjeve, atëherë zgjedhjet në atë zonë shtyhen për katër javë. Në këtë rast KQZ-ja cakton një datë tjetër për paraqitjen e kandidaturës zëvendësuese.
5. Në rast se kandidati vdes, subjekti zgjedhor mund të depozitoj kërkesën për rregjistrimin e kandidatit zëvendësues, jo më vonë se 48 orë nga vdekja e tij.
6. KQZ/KZAZ merr vendim brenda 24 orëve nga depozitimi i kërkesës për zëvendësimin e kandidatit.
7. Kundër vendimit të KZAZ/KQZ-së mund të bëhet ankim pranë KQZ/Kolegjit Zgjedhor brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit. KQZ/Kolegji Zgjedhor vendos brenda 48 orëve.

-----

❖ **Rekomandime të patrajuara, që i janë paraqitur Kuvendit ne vitin 2014.**

KQZ, gjithashtu risjell në vëmendje çështjeve të tjera, të cilat kanë qënë objekt i diskutimeve gjithpërfshirëse në tryezat teknike të organizuara nga KQZ me mbështetjen e OSBE përgjatë vitit 2014, dhe që si paketë propozimesh i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë për t'u vlerësuar dhe materializuar në Kodin Zgjedhor, por që vijojnë të mbeten të patrajuara. Konkretisht:

**VI-REKOMANDIME PËR USHTRIMIN E TË DREJTËS SË VOTËS NGA PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Për garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar, detyrim kushtetues dhe njëherazi interes dhe vëmendje e shoqërisë, tryeza konkludoi në disa rekomandime për përmirësimet në Kodin Zgjedhor:

- Është e domosdoshme të përforcohen dispozitat të cilat i referohen masave që duhet të merren për garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës për personat që nuk mund të votojnë vet;
- Të reflektohen ndryshime dhe përmirësime ligjore në frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Të përcaktohen sanksione ndaj pushtetit vendor, në rast të mosrespektimit të ligjit dhe detyrimeve për garantimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së votës nga Personat me Aftësi të Kufizuara; Kodi zgjedhor duhet të përcaktojë si dispozitë urdhëruese dhe jo si zgjidhje alternative detyrimin e pushtetit vendor për të garantuar infrastrukturën ndihmëse në çdo qendër votimi ku janë të regjistruar zgjedhës që nuk mund të votojnë vet. Ky detyrim duhet të monitorohet nga KQZ, e cila duhet të ketë në dispozicion mekanizma ligjorë, të cilat i japin mundësi të marrë masa administrative ndaj drejtuesve të pushtetit vendor, të cilët nuk i përgjigjen kërkesave të ligjit dhe autoritetit monitorues;
- Kodi Zgjedhor duhet të shprehet për të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuar intelektuale (PAKI), i cili vazhdon të mbetet një problem i lënë në heshtje dhe që në fakt nuk ka patur raste të kufizimit. Në këtë këndvështrim, Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë mënyrat dhe nevojat për përshtatshmëri duke ju referuar nocioneve/llojit të paaftësisë dhe jo të përgjithësuar;

- Kodi Zgjedhor nuk duhet të përcaktojë procedura të cilat lidhen me ndarje të përgjegjësiwe institucionale për përgatitje të listave të personave që nuk mund të votojnë vet, pasi ky fakt, jo vetëm që shpërndan dhe më shumti shmang përgjegjësiwe institucionale, por lë hapësirë edhe për abuzime procedurale. Në përmirësim të kësaj dispozite, Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë që në propozimet dhe vendimmarrjen institucioneve publike (sidomos pushtetit vendor) të cilat kanë përgjegjësi problematikën e personave me aftësi të kufizuar, të ketë edhe përfaqësim të shoqatave të PAK;
- Kuvendi i Shqipërisë duhet që të marrë në konsideratë dhe të bëjë pjesë të procesit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor edhe përfaqësuesit e Grupit të Interesit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët, për shkak të përvojës dhe ekspertizës mund të ofrojnë zgjidhje ligjore dhe teknike shumë më efektive;
- Përtej rekomandime për ndryshime te legjislacionit zgjedhor, i cili është vetëm një aspekt i zgjidhjes së problemit, Grupet e Interesit mund ti drejtohen me një letër të hapur Qeverisë Shqiptare për të filluar një projekt monitorimi në të gjithë vendin për krijimin e infrastrukturës ndihmëse për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha objektet të cilat ofrojnë shërbime publike dhe sociale.

KQZ, për materializimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të kësaj tryeze, sygjeron ndryshime të disa dispozitave të Kodit Zgjedhor, konkretisht:

| <b>Është</b>  | <b>Propozohet të bëhet:</b>  |
|---|--|
| <b>Neni 2, pika 2</b><br><b>“Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë.</b>                         | Neni 2, pika 2<br>“Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë si dhe institucionet reabilituese/riaftësuese të personave me aftësi të kufizuar dhe shtëpitë e të moshuarve.   |
|   | <b>Neni 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtje:</b><br>“2/1. “Zgjedhës me aftësi të kufizuar” janë ata zgjedhës, që kanë aftësi të kufizuar fizike, shqisore apo intelektuale, të lindur apo të fituar gjatë jetës apo për shkak të moshës së avancuar, vërtetuar kjo me një dokument zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë.” |
| <b>Neni 108</b><br><b>Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë</b><br><b>“1. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi</b> | <b>Neni 108</b><br><b>Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë</b><br>„1.Njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim sigurimin e qendrave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, kryejnë  |



tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

**2.Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.**

**3.Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.**

**4.Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.**

**5.Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.**

**6.Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.**

**7.Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në**

detyrat si më poshtë:

- a) Identifikojnë personat me aftësi të kufizuara në njësitë e tyre, sipas listave që disponojnë dhe sipas informacionit që kërkojnë nga institucione të tjera. Identifikimi përfshin numrin e personave me aftësi të kufizuar dhe llojin e aftësive të kufizuara;
- b) Identifikojnë qendrat e votimit të tyre dhe nivelin e aksesueshmërisë në to;
- c) Sigurojnë përshtatshmërinë në qendrat të votimit sipas sipas gjetjeve të pikës 1, a, b.

2. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore nuk mund të realizojë përshtatjen e qendrës së votimit, ku votojnë persona me aftësi të kufizuara, vendndodhja e qendrës së votimit mund të caktohet në një qendër votimi të ndryshme nga ajo e zgjedhjeve të fundit.

3. Zgjedhësi, që për shkak të aftësisë së kufizuar nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit.

4. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

5. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

6. Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve

**mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.**

**8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.”**

dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

7. Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

8. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e tjerë PAK, të cilët nuk janë të regjistruar sipas pikës 1 (a) të këtij neni, kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, rregjistrimin e tyre si zgjedhës që kanë nevojë për përshtatje të arsyeshme të qendrës së votimit;

Kërkesa për regjistrim, sipas pikës 8 shoqërohet me kopje të dokumentacionit zyrtar që provon llojin e aftësisë së kufizuar dhe dorëzohet pranë njësisë së qeverisjes vendore nga vetë personi ose një familjar i tij, ku ka vendbanimin personi, brenda periudhës së rishikimit të listës zgjedhore. Njësia e qeverisjes vendore harton një formular tip për këtë qëllim.

9. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, përgatit njëkohësisht listën e personave me aftësi të kufizuar sipas pikës 1 (a) dhe pikës 8 në njësinë e vet.

10. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas informacionit të marrë sipas pikes 8 të këtij neni, njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe

të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton sipas pikës 3.”

## VII-REKOMANDIME PËR RITJEN E PJESËMARRJES SË GRAVE NË ORGANET E ZGJEDHURA

Diskutimet e tryezës së organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me mbështetjen e UN EOMEN (United Nations for Gender Equality and the Empowerment of Women, me fokus diskutimin e rritjen e pjesëmarrjes së grave në organet e zgjedhura, sollën gjetje dhe rekomandime për ndryshime në Kodin Zgjedhor:

- Vendosjen në kuadrin e parimeve të përgjithshme lidhjen që ka një ligj i rëndësishëm siç është Kodi Zgjedhor me çështjen e barazisë gjinore.
- Respektimin e kuotës gjinore në përbërjen e KQZ-së dhe KZAZ-së duke garantuar që edhe në rast zevendësimi, anëtari që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar do të jetë po i kësaj gjinie.
- Vendosjen e kuotës gjinore në nivelin e KQV-së dhe GNV-së si detyrim ligjor dhe ruajtjen e saj gjatë gjithë veprimtarisë së KQV-së
- Detyrimin e KQZ-së që të përfshijë në Buletin e Zgjedhjeve të dhëna statistikore për pjesëmarrjen në zgjedhje të gjinisë më pak të përfaqësuar dhe rezultatet zgjedhore për kandidatët nga kjo gjini. KQZ-ja duhet të publikojë gjithashtu të dhëna statistikore për çështjet gjinore për përbërjen e organeve të zgjedhura ose të emëruar nga Kuvendi, duke përditësuar këto të dhëna ndër vite.
- Vendosjen dhe zbatimin e kuotës gjinore në mënyrë të plotë në përbërjen e Kuvendit duke përcaktuar renditjen e kandidatëve në mënyrë alternative sipas gjinisë. Ky formulim është i qartë dhe është i prerë dhe garanton përbërjen të paktën 30 përqind të këtij organi nga gjinia më pak e përfaqësuar.
- Sanksionimin në ligj të refuzimit të regjistrimit të listave shumëmemërore në rast të mosrespektimit të gjinisë në zgjedhjet për Kuvendin. Konstatimin nga KQZ të pavlefshmërisë absolute të cdo mandati të fituar në zgjedhjet për organet e Qeverisjes vendore, në rast se subjekti nuk ka respektuar kriterin e gjinisë në listat shumëmemërore.
- Ti jepet përfundimisht fund “lojës” në kurriz të ligjit që po zhvillohet aktualisht në Shqipëri nga partitë politike me dorëheqjet e stimuluar të kandidateve gra në listat shumëmemërore. garantimin se përherë sa herë krijohet vakancë poltësimi i saj behet nga kandidate femra të listave shumëmemërore, dhe në rastet e shterimit të listave të kandidateve femrave plotësimi të bëhet nga kandidatë femra të partive të tjera branda koalicionit.
- Garantimin e zbatimit të kuotës gjinore në përbërjen e organeve të zgjedhura duke parashikuar në to edhe mekanizmat që garantojnë zbatimin e saj.

KQZ, për materializimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të kësaj tryeze, sugjeron ndryshimet përkatëse në Kodin Zgjedhor:

| <b>Është</b>           | <b>Propozohet të bëhet:</b>  |
|------------------------|--|
| <b>Neni 2, pika 21</b> | <p><b>Neni 2, pika 21</b></p> <p>“Votim për të tretët” është votimi kur zgjedhësi voton në emër dhe për llogari të personave të tjerë, të pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 108 të këtij Kodi, votimi për të tretët është i kundërligjshëm dhe dënohet sipas Kodit Penal.</p>   |
|                        | <p><b>Neni 2, pas pikës 21, shtohet pika 21/1 me përmbajtjen si vijon:</b></p> <p>“Votim familjar” është formë e votimit për të tretët dhe ndodh kur një pjestar i familjes, si rregull kryefamiljari, voton në emër dhe për llogari të pjestarëve të tjerë.</p>   |
|                        | <p>Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:</p> <p><b>“Neni 3/1</b></p> <p><b>Kodi Zgjedhor dhe barazia gjinore</b></p> <p>1. Ky Kod garanton parimin e barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislativi në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë më pak të përfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij Kodi nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.</p> <p>2. Detyrimi sipas pikës së parë të këtij neni i përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë mbi tagrat që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij Kodi, të kërkojë nga subjektet zgjedhore pushimin e cënimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.</p> <p>3. Kodi Zgjedhor nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën</p> |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>zgjedhore përmes:</p> <p>a) vendosjes së kuotave gjinore në jo më pak se 30 përqind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe në cdo dy emra nga secila gjini në organet e njësive bazë të qeverisjes vendore,</p> <p>b) vendosjes së kuotave gjinore në jo më pak se 30 përqind të përbërjes së të gjithë niveleve të administratës zgjedhore,</p> <p>c) marrjes së masave në reduktimin dhe eliminimin e votimit për të tretët, votimit familjar, ruajtjen dhe garantimin e fshehtësisë së votimit.</p> <p>ç) hartimit dhe publikimit të statistikave operative për pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në ditën e zgjedhjeve, si dhe të statistikave të sakta për pjesëmarrjen e saj në votime dhe rezultatin e zgjedhjeve, me qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të duhura për të nxitur më tej këtë pjesëmarrje.”</p> |
|   | <p><b>Në nenin 19, pika 2 në fund shtohet kjo fjali:</b> “Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së të gjinisë më pak të përfaqësuar zëvendësimi me anëtarin e ri bëhet kurdoherë nga gjinia më pak e përfaqësuar.”</p>  |
| <p><b>Neni 21, pika 12</b></p> <p>“Boton buletin e zgjedhjeve, i cili përmban rezultatet e zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore dhe qendër votimi, raportin për shpenzimet zgjedhore, si dhe publikon raportet, sipas nenit 91 të këtij Kodi.”</p> | <p><b>Neni 21, pika 12</b></p> <p>“Boton buletin e zgjedhjeve, i cili përmban rezultatet e zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore dhe qendër votimi, raportin për shpenzimet zgjedhore, si dhe publikon raportet, sipas nenit 91 të këtij Kodi. <b>Në buletin e zgjedhjeve publikohen edhe të dhënat statistikore për pjesëmarrjen në zgjedhje të gjinisë më pak të përfaqësuar dhe rezultatet zgjedhore për kandidatët nga kjo gjini.”</b></p>  |
|   | <p><b>Pas pikës 12 shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:</b></p> <p>“12/1. KQZ-ja publikon të dhënat statistikore</p>   |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>për çështjet gjinore për përbërjen e organeve të zgjedhura ose të emëruar nga Kuvendi, duke përditësuar këto të dhëna ndër vite.”</p>   |
| <p><b>Neni 32</b></p> <p>“Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:</p> <p>a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZAZ-së;</p> <p>b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;</p> <p>c) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose</p> <p>ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.</p> <p>2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:</p> <p>a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;</p> <p>b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë;</p> <p>c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;</p> <p>ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;</p> <p>d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.</p> <p>3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në</p> | <p><b>Neni 32, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:</b></p> <p><b>4. Në rast se anëtari apo sekretari i KZAZ-së që lirohet ose shkarkohet i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, subjektet propozuese duhet të paraqesin kandidaturë zëvendësuese po nga gjinia më pak e përfaqësuar. Në rast të kundërt, kërkesa për zëvendësim refuzohet. Në rast të mungesës së kuorumit të nevojshëm për funksionim dhe vendimmarrje, KQZ-ja emëron kryesisht anëtarë të KZAZ-së nga gjinia më pak e përfaqësuar, sipas pikës 5 të nenit 29 të këtij Kodi.”</b></p> |

|   |  |
|---|--|
| <p>shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast."</p>  |  |
| <p><b>Neni 36, pika 1</b><br/> "KQV-ja përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhjeje, me përjashtim të shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 29 të këtij Kodi".</p> | <p><b>Neni 36, pika 1</b><br/> "KQV-ja përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. <b>KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhje. 30 përqind e listës së anëtarëve të KQV-ve, propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare, në rang ZAZ-je, duhet të jenë nga secila gjini"</b></p>   |
|   | <p><b>Në nenin 39 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:</b><br/> "3. Në rast se anëtari apo sekretari i KQV-së që lirohet ose shkarkohet i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, subjektet propozuese duhet të paraqesin kandidaturë zëvendësuese po nga gjinia më pak e përfaqësuar. Në rast të kundërt, kërkesa për zëvendësim refuzohet. Në rast të mungesës së kuorumit të nevojshëm për funksionim dhe vendimmarrje, KZAZ-ja emëron kryesisht anëtarë të KQV-së nga gjinia më pak e përfaqësuar, sipas pikës 5 të nenit 36 të këtij Kodi."</p> |
|   | <p><b>Në nenin 61, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:</b><br/> "1/1. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bën publikimin e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë sipas nenit 51 të këtij Kodi, si dhe kur përmbushet afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit 56, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dorëzon KQZ-së, përveç numrit të zgjedhësve në rang vendi, edhe të dhënat e mëposhtme statistikore:<br/> a) numrin dhe përqindjen e zgjedhësve sipas gjinisë, në rang vendi, zone zgjedhore dhe</p>            |

|  |   |
|--|---|
|  | <p>zone qendre votimi;</p> <p>b) numrin dhe përqindjen e zgjedhësve që votojnë për herë të parë në rang vendi, zone zgjedhore dhe zone qendre votimi;</p> <p>c) numrin dhe përqindjen e zgjedhësve deri në moshën 30 vjeç në rang vendi, zone zgjedhore dhe zone qendre votimi;</p> <p>ç) numrin dhe përqindjen e zgjedhësve nga 30 deri në 50 vjeç në rang vendi, zone zgjedhore dhe zone qendre votimi;</p> <p>d) numrin dhe përqindjen e zgjedhësve mbi 50 vjeç në rang vendi, zone zgjedhore dhe zone qendre votimi.</p> <p>Këto të dhëna mbahen të përditësuara dhe publikohen nga KQZ-ja pas marrjes së tyre në dorëzim dhe në Buletinin e Zgjedhjeve.”</p> |
| <p><b>Neni 67, pika 6 (paragrafi I-rë)</b></p> <p>“6.Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtijnit 164 të këtij Kodi”</p>  | <p><b>Neni 67, pika 6 (paragrafi I-rë)</b></p> <p>“6. Për çdo zonë zgjedhore jo më pak se një në çdo tri emra të njëpasnjëshëm të listës shumemërore duhet t’i përkasë secilës gjini.”</p>  |
| <p><b>Neni 95*</b></p> <p>Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)</p> <p>1. Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Numri i grupeve të numërimit është dy për çdo tavolinë numërimi, sipas pikës 2 të nenit 94 të këtij Kodi. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e neneve 30 dhe 31 të këtij Kodi. Propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve.”</p> | <p><b>Në nenin 95, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:</b></p> <p><b>“Secila listë me anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave duhet të përmbajë jo më pak se 30 përqind anëtarë të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në të kundërt lista e subjektit refuzohet dhe grupet respektive të numërimit vijojnë punën me numër më të pakët anëtarësh ose KZAZ-ja emëron kryesisht anëtarë nga gjinia më pak e përfaqësuar, sipas pikës 3 të nenit 95 të këtij Kodi, në rast se grupi i numërimit ka më pak se dy anëtarë.”</b></p>  |
| <p>Neni 164, pika 2</p> <p>“2. Mandati i ndërprerë i deputetit ose i</p>   | <p><b>Neni 164, pika 2</b></p>  |



|  |   |
|--|---|
| <p>anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.”</p>   | <p>2. Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të këtij Kodi, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. <b>Në rast se emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar mandati i kalon kandidatit të gjinisë përkatëse të partisë politike të koalicionit me herësin më të lartë. Ky proces zëvendësimi vijon duke garantuar përherë plotësimin e vakancës vetëm me kandidate të së njëjtës gjini.”</b></p>  |
| <p>Neni 175</p> <p>Sanksionet në lidhje me barazinë gjinore</p> <p>1. Mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 67, të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni, në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin, dhe me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.</p> <p>2. Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Në rast se KQZ-ja vendos aplikimin e këtij sanksioni, përjashtimi i pikës 2 të nenit 164 nuk zbatohet dhe vakanca</p> | <p><b>“Neni 175</b></p> <p><b>Sanksionet për mosrespektim të barazisë gjinore</b></p> <p>“1.Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të këtij Kodi pasjell refuzimin e listës shumëemërore për t’u rregjistruar në KQZ ose sipas rastit për zgjedhjet vendore në KZAZ.</p> <p>2. Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit për të paraqitur në listat shumëemërore për këshillat e bashkisë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm t’i përkasin seciles gjini, passjell pavlefshmërinë absolute të të gjithë mandateve që ka fituar subjekti zgjedhor përkatës në atë zonë zgjedhore. Pavlefshmëria absolute konstatohet nga KQZ menjëherë gjatë ndarjes së mandateve sipas nenit 163 të këtij Kodi ose në çdo kohë nga Kolegji Zgjedhor, me kërkesë të subjektit zgjedhor që ka interes të ligjshëm për të. Në</p> |

plotësohet sipas kësaj pike. 3. Sanksionet e përcaktuara në këtë nen vendosen për çdo zonë zgjedhore ku konstatohet shkelja.”

këtë rast përkatësisht KQZ ose Kolegji Zgjedhor vendos kalimin e mandateve të fituara partisë politike të koalicionit me herësin më të lartë si dhe bën shpërndarjen nominale të këtyre mandateve.”

## **SHTOJCË**

Në të gjithë këto vite dhe refoma zgjedhore që janë ndërmarrë në Shqipëri, fokusi kryesor është përqëndruar në zgjedhjet e përgjithshme, duke mbajtur në të njëjtën *status quo* dhe duke mos u përpjekur për të reformuar sistemin e zgjedhjeve vendore. Kjo përbën një të metë konstante të gjithë reformave zgjedhore në Shqipëri.

Ne vlerësojmë se përpjekja e parë nga ku duhet të nisë nxitja e barazisë gjinore edhe në sistemin e zgjedhjeve vendore është reformimi i këtij sistemi në Kodin Zgjedhor.

Më konkretisht tryeza rekomandoi;

1. Votimi për organet e qeverisjes vendore të bëhet sipas sistemit proporcional. Shkaqet që çuan Ligjvënësin drejt vendimit për sistemin proporcional në zgjedhjet e përgjithshme janë po aq të vlefshme edhe për zgjedhjet vendore. Votuesit të votojnë për subjektin zgjedhor, i cili paraprakisht ka rregjistruar një listë shumëemërore të kandidatëve. Votuesit në ditën e zgjedhjeve për organet bazë të njësisë vendore të jenë të pajisur vetëm me një fletë votimi, me të cilën të votohet si për kryetarin, ashtu dhe për këshillin.
2. Individit që është rregjistruar me numrin 1 në listën shumëemërore të subjektit zgjedhor është edhe kandidati për kryetar të bashkisë ose të komunës. Pjesa tjetër e individëve të listës janë kandidatët për këshillin e bashkisë ose të komunës.
3. Në listën shumëemërore, në rast se numri 1 i përket gjinisë mashkullore, duhet të pasohet në mënyrë të njëasnjëshme me dy kandidate nga gjinia femërore. Kështu në rast vakance të kryetarit, plotësimi bëhet nga kandidatët e gjinisë femërore.
4. Ne vlerësojmë se ky propozim nuk ka mospërputhje me dispozitat e Kushtetutës, por kërkon ndryshime themelore në Kodin Zgjedhor dhe ndryshime teknike në një sërë dispozitash të tjera me natyrë teknike si psh fleta e votimit, procedura e votimit, nxjerrja e rezultatit, tabelimi, etj.

## **VIII-REKOMANDIME PËR FUSHATAN ZGJEDHORE DHE MEDIAN**

Tryeza e organizuar nga KQZ me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri me përfaqësues të medias, të anëtarëve të Bordit të Monitorimit të Medias, të pedagogëve nga Departamenti i Gazetarisë UT, si dhe përfaqësues të disa organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, pati një rendësi të madhe. Nga te gjithë pjesëmarrësit u pranua se në

Shqipëri media si pushteti i katërt gjatë proceseve zgjedhore ka arritur disa standarte të larta dhe të gjithë pranuar dhe nga partnerët ndërkombëtar.

Tashmë në Shqipëri lira e shprehjes dhe e medias si një nga parimet e rëndësishme kushtetuese, është e konfirmuar. Nga një proces zgjedhor në tjetrin konstatohen arritje pozitive jo vetëm në konsolidimin e rregullimeve ligjore por edhe në rritjen e profesionalizmit, ndjenjën e përgjegjësisë së medias në raport me përqyrimin e proceseve zgjedhore, edukimin qytetar dhe institucionet e administrimit të zgjedhjeve, duke u shndëruar në një platformë të mirë për informimin dhe edukimin qytetar, në lidhje me fushatat zgjedhore, programet dhe misionet e çdo subjekti zgjedhor që merr pjesë në zgjedhje.

Por sigurisht përveç konsolidimit të këtyre arritjeve tryeza konstatoi dhe problematika, jo vetëm ato të paraqitura në raportet e OSCE/ODIHR, por dhe problematika të konstatuara nga dy proceset e fundit zgjedhore të dala nga analizat e anëtarëve të BMM, të ekspertëve të medias, dhe në ceshtje të tjera që lidhen me aspektin, administrativ dhe praktik të këtyre marrëdhënieve. Në analizë të tyre tryeza arriti në disa përfundime dhe rekomandime.

- Nisur nga fakti se neni 84, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe vendimi i KQZ-së në lidhje me pasqyrimin e fushatës zgjedhore bazuar në materialet e përgatitura nga subjektet zgjedhore nuk u interpretua drejtë dhe shkaktoi debat, nga një pjesë e aktorëve pjesëmarrës në zgjedhje, kjo dispozitë duhet të rishikohet duke shprehur në mënyrë të qartë të drejtën e medias për të zgjedhur nëse prodhon vetë lajme/kronika zgjedhore ose pranon të gatshme nga subjektet elektorale. Tryeza ishte e një mendje për përmirësimin e Kodit Zgjedhor për të përcaktuar qartë se çdo material i lidhur me fushatën, i përgatitur nga subjektet zgjedhore kryesisht duhet të identifikohet si material propagandistik i cili të transmetohet si pjesë e reklamës politike.
- Ekzistenca e dispozitave penale në Kodin Penal (2012, neni 120) që dënon me gjobë nga 50 mijë deri në 3 milion lekë personat që përhapin thënie apo informacione të rreme, rezultoi se përbën një shqetësim në fushatën elektorale sepse kufizon lirinë e shprehjes.
- Tryeza rekomandoi ndryshimet ligjore për shfuqizimin e këtij neni në kodin penal duke mos u klasifikuar më shpifja si vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit, por të rregullohet si mardhënie civile nga Kodi Civil.
- Tryeza konstatoi rishikimin e mënyrës së emërimit të anëtarëve të BMM duke e bërë procesin më transparent, më gjithëpërfshirës dhe më profesional.
- Tryeza propozoi disa variante, midis të cilëve varianti që në zgjedhjen e anëtarëve të BMM të zbatohet e njëjta procedurë shorti si në rastin e ekspertëve kontabël. Një numër subjektësh të medias, media publike e private, Universiteti i Tiranës (departamenti i gazetarisë), OJF që operojnë në sektorin e medias etj mund të propozojnë emra, të cilët më pas zgjidhen nëpërmjet procedurës së shortit në KQZ, si anëtar të BMM.
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë kriteret të qarta për emërimin e Anëtarëve të BMM.
- Tryeza rekomandoi përcaktimin e detyrimit ligjor për Autoritetin e Mediave Audiovizive për të mundësuar BMM të monitorojë të gjitha mediat kombëtare dhe lokale në të gjithë territorin, duke evituar disbalancimin dhe standardet e dyfishta në monitorime dhe

raportime në dy zgjedhjet e fundit. Kjo formë eviton rastet e konstatuara kur BMM nuk ka arritur të monitorojë media në qarqe të caktuara për pamundësi teknike ose mungesa në personel.

- Rezulton se partitë politike e fillojnë fushatën zgjedhore shumë kohë më parë se përcaktimi ligjor 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që media të mos lejohet të paqyrojë aktivitetet e partive politike në rastet kur partitë dhe subjektet elektorale e nisin fushatën zgjedhore kohë përpara fillimit të periudhës zgjedhore, procesi monitorues nëpërmjet Bordit të Monitorimit të Medias të përfshijë një periudhë më të gjatë se periudha zgjedhore. Gjithashtu Kodi Zgjedhor duhet të parashikoj një formulim të qartë të ndalimit të pasqyrimin në media të veprimtarive me karakter elektorale, jashtë periudhës së fushatës zgjedhore dhe sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të tyre.
  - Tryeza e konsideroi të drejtë kritikën dhe sugjerimin për detyrimin me ligj të mediave për zbatimin e kritereve të informimit të kandidatëve, sipas gjinis, si dhe për ndryshimin e praktikës së BMM, për përfshirjen e komponentit gjinor në metodologjinë e tij për monitorimin e medias.
  - Tryeza rekomandoi detyrimin ligjor të partive politike, të cilat brenda kohës që u vihet falas nga operatorët audiovizive, gjysmën /30% të saj, ta vënë në dispozicion për kandidatet femra.
  - Përcaktimin ligjor për vendosjen e kohës falas në dispozicion të kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit në Radio Televizionin Publikë për të shmangur standartet e dyfishta ndërmjet subjekteve zgjedhore në zgjedhje.
  - Tryeza rekomandoi përcaktimin ligjor të detyrimit të medias për të transmetuar informacion profesional për personat me aftësi të kufizuara, sidomos për grupet që nuk shikojnë/dëgjojnë.
  - Tryeza rekomandoi si domosdoshmëri për ritjen e profesionalizmit etikës dhe performancës për të gjithë aktorët pjesëmarrës në pasqyrimin në media të fushatës zgjedhore zhvillimin e trajnimeve. Trajnimi duhet të përfshijë krahas anëtarëve të BMM dhe stafit teknik në ndihmë të tij por dhe gazetarët, redaktorët dhe punonjësit e medias që merren direkt me fushatat zgjedhore, në mënyrë që ata të njohin nga afër dhe në detaje sistemin zgjedhor, sistemin administrues dhe detaje të tjera që lidhen me integritetin e procesit dhe informimin publik.
- 
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikoj si një nga masat administrative paraprake për operatorët radiotelevizivë privatë, kompesimin e kohës së transmetimit për balancimin e kohës televizive, sipas përcaktimeve të nenit 84.
  - Të përfshihen në monitorim edhe emisionet e veçanta televizive (si ato satirike) pasi emisione të tilla përveç informacionit transmetojnë komente, opinione, qëndrime politike ku sjellin denigrimin e kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore, duke sjellë ndikim të drejtëpërdrejtë tek zgjedhësit.
  - Kodi Zgjedhor nuk parashikon monitorimin e shtypit të shkryar, të printuar dhe online. Gazetat e printuara dhe portalet online nuk monitorohen përsa i përket mbulimit të

fushatës zgjedhore të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje. Mediat online dhe shtypi i shkruar i printuar kanë një impakt shumë të madh tek zgjedhësit, ndaj si rrjedhojë Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë monitorimin e pasqyrimin të fushatës së partive politike dhe kandidatëve edhe në shtypin e shkruar, të printuar dhe online(elektronik).

---

## **IX - REKOMANDIME PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE NË VIT KALENDARIK**

---

Në tryezën e rrumbullakët teknike "Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore" organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri u konstatua se:

- Gjatë viteve të fundit, vëmendja e publikut të gjerë për çështjet e financimit të partive politike është rritur ndjeshëm,
- Media, shoqëria civile, akademikët dhe qytetarët janë bërë më aktivë në kërkesën për të rritur monitorimin e partive politike në fushën e financave,
- Ndonëse kuadri ligjor për financimin e partive politike është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtyre viteve të fundit, zbatimi i duhur i tij ende çalon,
- Nga monitorimi bërë nga një organizatë e shoqërisë civile ka dalë që shpenzimet de facto të partive politike shkojnë në dy deri në katërfish të asaj që ato deklarojnë zyrtarisht,
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të kryejë hetime proaktive për të verifikuar llogaritë financiare të partive politike,
- Duhet të vendosen kanale komunikimi me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe duhet të realizohet një bashkëpunim i qartë mes KQZ-së dhe organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet,
- Gjatë një periudhe afërsisht 23-vjeçare, kuadri rregullator shqiptar për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore i është nënshtruar një transformimi tërësor. Nevojiten reforma të mëtejshme dhe kjo duhet realizuar së pari përmes një konsensus të gjerë politik ndërpartiak. Për këtë arsye, Tryeza doli me një listë rekomandimesh:

1. Publikimi i informacioneve financiare nga vetë partitë politike duhet të rregullohet nga dispozita ligjore të posaçme dhe të monitorohet nga KQZ-ja.

Partitë politike në Shqipëri nuk vënë në dispozicion të publikut, anëtarëve, apo votuesve të dhënat e tyre financiare. Një gjë e tillë shihet si treguesi kryesor i mungesës së përgjegjësisë dhe transparencës.

Nevojitet një dispozitë e posaçme ligjore për të rregulluar publikimin e këtyre informacioneve nga vetë partitë politike.

Për këtë qëllim, duhet të ndryshohet neni 23 i ligjit "Për partitë politike".

2. Duhet të përfshihen dispozita të qarta në ligj për të bërë ndarjen ndërmjet formatit të raportimit vjetor financiar për partitë nga raportimi i financave të fushatave zgjedhore gjatë viteve zgjedhore. Ligji duhet të parashikojë afate të prera për dorëzimin e raporteve në KQZ nga partitë politike si dhe detyrimin e KQZ-së për t'i publikuar këto raporte brenda afateve të mirëpërcaktuara. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor duhet të përmbajë një

dispozitë mbi "raportimin" e financimit të fushatës zgjedhore. Neni 23/4 i ligjit "Për partitë politike" i referohet raportimit të financave të fushatës zgjedhore, por kjo nuk është ende e parashikuar në Kodin Zgjedhor.

Për këtë qëllim, paragrafi 4 i nenit 23 të ligjit "Për partitë Politike" duhet ndryshuar.

3. Formati aktual i auditimit i përcaktuar me ligj është tepër i detajuar dhe e bën voluminoze punën e auditimit. Duhet kërkuar një formë "më e zhveshur" e bilanceve, që përmban atë çka është e rëndësishme, si për shembull të ardhurat, shpenzimet, huatë, etj.

Specialistët e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) rekomandojnë që në ligj të përmendet standardi kontabël i njohur si "EVR" (Expenditure Verification Report). Ky standard duhet të vendoset në ligj si rregull i përgjithshëm dhe KQZ-së, në bashkëpunim me IEKA-n, duhet t'i jepet kompetenca të miratojë rregullat dhe rregulloret teknike që plotësojnë kuadrin ligjor.

Për këtë qëllim, paragrafi 5 i nenit 23 të ligjit "Për Partitë Politike" dhe neni 91 i Kodit Zgjedhor duhen ndryshuar.

4. Deri tani, KQZ-ja ka qenë e detyruar të bëjë auditimin e një numri të madh të partive politike të regjistruara në Regjistrin e Partive Politike në Gjykatën e Rrethit Tiranë (125). Për më shumë se 50% prej tyre nuk ka asnjë informacion për adresat dhe kryetarin e partisë, të cilat pasqyrohen në regjistrin e Gjykatës.

Ligji "Për Partitë Politike" duhet të ofrojë një zgjidhje ligjore për këto rrethana. Partitë duhet të jenë të detyruara me ligj që, nëse ndryshojnë adresë, duhet të njoftojnë zyrtarisht KQZ-në brenda një afati të caktuar, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë partia apo nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Nëse një detyrim i tillë nuk respektohet, ligji duhet të ofrojë një mekanizëm dhe procedurë për t'u ndjekur (si njoftimet publike), si dhe sanksione proporcionale për raste të tilla.

Për këtë qëllim, neni 11 i Ligjit "Për Partitë Politike" duhet ndryshuar.

5. Raportet financiare i dorëzohen KQZ-së dhe publikohen nga kjo e fundit në periudha të ndryshme kohore. Ekziston një boshllëk ligjor në lidhje me afatin e dorëzimit, sepse ligji "Për Partitë Politike" nuk përcakton datën e raportimit.

Për këtë qëllim, neni 23 i ligjit "Për Partitë Politike" duhet ndryshuar.

6. Ligji "Për Partitë Politike" përcakton që kontrolli i financave të partive duhet bërë çdo vit për secilën nga mbi 140 partitë të regjistruara në Gjykatë. Por rreth 50% e partive politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Tiranë nuk kanë marrë pjesë në katër garat e fundit zgjedhore.

Ligji duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm për kontrollin e financave të partive në kushtet e kufizimeve në buxhet dhe burime njerëzore. Ligji duhet të përcaktojë shprehimisht prioritetet për kontrollin e financimit të partive. Prioritet mund të jenë për shembëll kontrolli vjetor për ato parti që përfitojnë nga fondet publike.

Për këtë qëllim duhet shtuar një nen i ri në ligjin "Për Partitë Politike".

7. Neni 23/1 i ligjit "Për partitë politike" parashikon që lista e personave që dhurojnë më shumë se 100 000 lekë (afërsisht 720 EUR) duhet të bëhet publike. Neni 90, paragrafi 2 i

Kodit Zgjedhor parashikon që fondet jopublike me vlerë më të madhe se 100 000 lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor dhe që përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim.

Ky prag është shumë i lartë dhe lë shteg që të pengohet bërja e transparencës së burimeve të financimit nën këtë shumë.

Sipas Open Data Albania: Fushata zgjedhore 2009: 59% e vlerës së 'Donacioneve' ka si burim donatorët të shumave nën 100 mijë lekë. Në vlerë absolute, kjo është 64 435 904 lekë. Pjesa tjetër, pra 41%, janë donatorë të shumave mbi 100 mijë lekë. Fushata Zgjedhore 2011: 78,8% e vlerës së 'Donacioneve' janë nga donatorë të shumave nën 100 000 lekë, që nuk janë objekt i nenit 90 të Kodit Zgjedhor. Fushata Zgjedhore 2013: 30% e vlerës së 'Donacioneve' janë donacione me vlerë nën 100 000 lekë.

Ndaj, këto dispozita duhen ndryshuar me qëllim që të ulët ky prag (deri në 150 euro, sa paga minimale), në mënyrë që të bëhen publike të gjitha dhurimet që i bëhen partive politike

8. Neni 88 i Kodit Zgjedhor duhet të parashikojë në mënyrë më rigorozë moslejimin e përdorimit të burimeve publike për mbështetjen e subjekteve zgjedhore. KQZ-ja duhet të jetë kompetente për miratimin e të gjithë mekanizmave të nevojshëm për të parandaluar abuzimin me burimet shtetërore nga partitë politike. Nëse kjo ndodh, KQZ-ja duhet të reagojë menjëherë duke marrë të gjitha masat dhe vendosur gjobat e nevojshme që kjo të mos përsëritet në ditët në vazhdim të fushatës zgjedhore.

Për këtë qëllim, neni 88 i Kodit Zgjedhor duhet ndryshuar.

9. Neni 89 i Kodit Zgjedhor parashikon që ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ai/ajo ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë; ushtron veprimtari në fushën e medias; ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; apo ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk e rregullon çështjen e konfliktit të interesit edhe për periudhën paszgjedhore. Duhet parë nëse ka konflikt interesi në financimin e partive jo vetëm para datës së zgjedhjeve, por edhe pas tyre.

Përveç kësaj, duhen parashikuar kufizime edhe për donatorët individualë, në mënyrë që donatorët e partive të mos caktohen pas zgjedhjeve në funksione publike në administratën shtetërore apo në shoqëritë me kapital shtetëror.

Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë institucionin që duhet të ushtrojë kontroll mbi këto çështje dhe të parashikojë sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të tyre.

Për këtë qëllim, neni 89 i Kodit Zgjedhor duhet ndryshuar.

10. Ligji "Për partitë politike" nuk bën një rregullim të reklamave politike në media gjatë aktivitetit vjetor të partive politike (fushatave jozgjedhore). Edhe pse ligji nuk garanton për partitë barazi çmimesh për reklamat mediatike, partitë kanë në fakt akses në reklamat mediatike me pagesë. Frekuenca e reklamave është e lartë, sidomos gjatë fushatave zgjedhore apo edhe përpara fillimit zyrtar të fushatave. Po të krahasosh çmimet e

zakonshme të kompanive mediatike, kostoja e kohës televizive dhe reklamave duket e lartë; partitë duhet t'i bëjnë publike detajet e këtyre kostove në raportimet e tyre financiare. Vendimmarrësit duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse nevojitet që kohëzgjatja e fushatës zgjedhore të zbatohet në mënyrë më efektive (apo të ndalohen reklamat jashtë fushatës zgjedhore), apo nëse duhet të kufizohen reklamat (për shembull të ndalohen në televizionet private apo të kufizohet ndjeshëm sasia në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet).

Prandaj, nevojitet që ligji "Për partitë politike" të përmbajë disa nene që garantojnë stimuj financiarë për kompanitë mediatike që ato të bëjnë publike informacionet mbi kohën televizive dhe kostot e reklamave të paguara nga partitë politike.

11. Kodi Zgjedhor dhe ligji "Për partitë politike" duhet të parashikojnë qartësisht kompetencën e KQZ-së për t'i paraqitur konstatimet e saj për shqyrtim pranë prokurorisë apo zyrës së administratës tatimore.
12. Kodi Zgjedhor dhe ligji "Për partitë politike" duhet t'u ofrojnë një lloj garancie apo mbrojtjeje ekspertëve kontabël që ata ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe profesionale, pa ndikime apo intimidim të jashtëm politik, sidomos kur auditojnë financimin e partive kryesore në pushtet apo partive që fitojnë zgjedhjet.
13. Neni 84, paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor krijon një burim financiar shtesë për partitë e rëndësishme politike. Mënyra se si ai zbatohet implikon në transaksione financiare dhe aktivitete fiskale edhe institucionet mediatike, duke krijuar situata ekonomike konfidenciale mes partive dhe radio/televizioneve. Ky është një nen shumë i vështirë për t'u monitoruar dhe përfshin disa struktura monitorimi (bordin e medias, zyrën e tatimeve, etj.).

Ky nen është zbatuar në mënyrë arbitrare në zgjedhjet e vitit 2011 nga të paktën një parti dhe dy kompani mediatike, edhe pse ai duhet të zbatohet vetëm për zgjedhjet parlamentare.

Neni 84 paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor parashikon se "Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t'ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohen KQZ-ja, KKRT-ja dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse." Këtu kemi dy çështje: i) financimi i 50% të kohës nga shteti është financim shtesë i fshehur, dhe për më tepër sasia e këtij financimi nuk është e qartë, sepse dispozita shprehet gjysma e kohës, jo gjysma e kostos; dhe ii) në praktikë, Open Data Albania ka vëzhguar që një parti politike ka raportuar që për zgjedhjet lokale të vitit 2011 kishte përfituar, në bazë të nenit 84, paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor, kohë falas për reklamë politike të vënë në dispozicion nga radio/televizionet private, që u llogarit si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ky element i veçantë i bilancit u regjistrua si zë më vete nga eksperti kontabël.



14. Neni 90, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor i lejon publikut të ketë akses në informacionet rreth donacioneve me vlerë më të lartë se 100 000 lekë. Ligji parashikon që këto të dhëna duhet të bëhen "gjithmonë publike", që do të thotë se e drejta e informimit fillon në momentin që donacioni regjistrohet në llogarinë bankare përkatëse.

Gjatë Fushatës Zgjedhore të vitit 2013, ekipi që punoi për Open Data Albania u kërkoi me shkrim tetë partive kryesore që të bënin publik donatorët e tyre që nga fillimi i fushatës. Megjithëse kërkesa u bë në formë zyrtare, ky informacion nuk u vu ndonjëherë në dispozicion qoftë gjatë apo pas fushatës. Partitë politike u përpoqën të argumentonin se ato nuk janë objekt i kësaj dispozite ligjore, dhe disa prej tyre u përgjigjën edhe se ato nuk janë objekt i të drejtës për informim, d.m.th. nuk janë të detyruara nga ligji shqiptar për të drejtën e informimit që ta japin këtë informacion.

Ndaj, Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë të tillë që të garantojë transparencën dhe të drejtën e informimit mbi financimin e partive politike. Ligji duhet jo vetëm të parashikojë dhënien e informacioneve të një natyre të përgjithshme, por edhe të japë zgjidhje efektive dhe të përcaktojë sanksione në raste shkeljesh.

15. Duhet të fuqizohet roli i KQZ-së duke i siguruar asaj buxhet dhe burime njerëzore të mjaftueshme për të ushtruar në kohë dhe me efikasitet kompetencat që i jep ligji. Kjo mund të realizohet në bazë të një vlerësimi të detajuar të ndikimit rregullator.

16. Ligji duhet të ofrojë mekanizma për ta bërë pjesëmarrjen në auditimin e financimit të partive politike më tërheqëse për ekspertët e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë. Detyra e ekspertëve kontabël është shumë delikate dhe ligji i detyron ata që të konstatojnë dhe të firmosin raporte mbi rregullsitë apo parregullsitë financiare të subjekteve shumë të fuqishme (ekzekutive dhe legjislative).

Çështja e pagave të papaguara duhet të zgjidhet përmes buxhetit të KQZ-së. KQZ-ja, si organi administrativ që u ngarkon detyra ekspertëve kontabël përmes shortit, është e detyruar të garantojë që ata do të paguhen për punën që vetë KQZ-ja u ngarkon. Në rastet kur partitë politike nuk e përmbushin këtë detyrim për të bërë pagesat, atëherë KQZ-ja duhet të paguajë për shërbimet e ekspertëve kontabël dhe ta llogarisë shumën si një detyrim që partitë ia kanë asaj.

17. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë që të parashikojë një zvogëlim proporcional të financimit të partive politike nga fondet publike gjatë fushatave zgjedhore, nëse ato nuk respektojnë kuotën gjinore të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

#### **X-REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E PLATFORMËS SË TRAJNIMIT TË KOMISIONERËVE ZGJEDHORË DHE TË EDUKIMIT ZGJEDHOR**

Trajnimi i komisionerëve zgjedhorë, si elementi më i rëndësishëm që garanton profesionalizmin e tyre, është një çështje që diskutohet prej mëse një dekade duke qenë pjesë e axhendës së të gjitha komisioneve parlamentare të reformës zgjedhore në Shqipëri, po ende pa gjetur zgjidhjen optimale. Cilësia e njohjes së ligjit dhe procedurave zgjedhore të personave të përshirë direkt/indirekt në proceset zgjedhore, në jo pak raste

raportohen nga grupe vëzhguese ose ankimime të evidentuara nga media/subjektet elektorale.

KQZ e solli në diskutim gjithpërfshirës këtë aspekt thelbësor për mirë organizimin dhe mirë administrimin e procesit zgjedhor, për faktin se pavarësisht përkushtimit dhe fleksibilitetit të KQZ për ta bërë procesin e trajnimit sa më eficient, përgatitjeve të qëndrueshme, sërish dëshmohen problematika që reduktojnë efektivitetin e tij, ku më thelbësoret mbeten emërimet e vonuara dhe lirim/emërimet në vijimësi, edhe ditën e zgjedhjeve. Tryeza e hapur konsultative "Praktikat më të mira dhe platformat e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë", e organizuar nga KQZ më 31.3.2014, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, kishte pjesëmarrës përfaqësuesit kryesorë të partive politike, organizatave që veprojnë në çështjet zgjedhore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, grupe interesi, trajnues, administratën e institucionit si dhe Drejtoret e Qendrave të Trajnimit të Vazhduar Zgjedhor të Gjeorgjisë dhe Moldavisë, të cilat prezantuan modelet e trajnimit zgjedhor të aplikuar në këto dy vende me karakteristika dhe sfida të përafërta me Shqipërinë.

Në vlerësimin të nevojës që e gjithë trupa e administrimit zgjedhor, pavarësisht burimit të emërtesës apo zgjedhjes, duhet të dëshmojë më shumë pavarësi, më shumë profesionalizëm dhe më shumë besueshmëri publike, tryeza dakortësoi se problemet kryesore që reduktojnë efektivitetin e trajnimeve të organizuara nga KQZ, duke cënuar profesionalizmin e administratës zgjedhore, vazhdojnë të mbeten:

- lirimet/emërimet në vijimësi madje deri në ditën e zgjedhjeve të komisionerëve të nivelit të II-të (35.5% në zgjedhjet 2013, 37% në zgjedhjet 2015), dhe emërimet në tejkalim të skajshëm të afatit ligjor të komisionerëve të nivelit të tretë ( KQV) dhe grupeve të numërimit.
- Ndërvarur nga vullneti politik për paraqitjen në kohë të propozimeve për nivelin e tretë (KQV dhe GN), zëvendësimet në vijim (megjithëse në shkelje të ligjit), efektiviteti i procesi i trajnimit për këtë nivel të administratës zgjedhore mbetet i reduktuar, dhe në kushtet e pamundësisë pothuaj absolute të testimit e njohurive;
- Një pjesë e madhe e komisionerëve të qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit, shërbejnë në detyrë pa marrë trajnimin profesional të ofruar nga KQZ-ja.

Tryeza, në vlerësim të dokumentave ndërkombëtarë si "Kodi i Praktikës së mirë për çështjet zgjedhore", suksesit të organizimit të trajnimeve përmes një Qendre institucionale sikundër në Gjeorgji dhe Moldavi, ritheksoi nevojën për shndërrimin e procesit të trajnimit zgjedhor në një sistem unik përfshirës dhe funksional. Përfundimet dhe gjetjet kryesore të tryezës ishin:

#### NEVOJA DHE EMËRIMI:

- Procesi i trajnimit institucional dhe afatgjatë i komisionerëve dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor, si dhe procesi i edukimit zgjedhor, duhet të kryhet nga një mekanizëm i qëndrueshëm, i përhershëm, me status, financim dhe strukturë të veçantë. Në fazën e parë të projektit kjo mund të arrihet në kuadër të KQZ për të kaluar më pas në një qendër trajnimi dhe edukimi zgjedhor të vazhduar, si njësi e pavarur dhe funksionale.

- KQZ, mbetet e përkushtuar për të përmbushur me përgjegjshmëri detyrimin dhe përgjegjësinë për trajnimin e administratës zgjedhore.
- Tryeza ishte unanime në vlerësimin se procesi i trajnimit në çdo rast përfshin aktorët politikë ndaj duhet të jetë i hapur ndaj çdo kërkesë të subjekteve zgjedhore për tematika dhe kërkesa trajnuese që nuk ndikojnë në thelbin e procesit të trajnimit, në integritetin e tij thellësisht profesional dhe largimin e çdo ndikimi nga interesat politike.
- Në ngritjen, funksionimin dhe jetësimin praktik të Qendrës, përveç praktikave rajonale të sjella në tryezë, vlerë referuese thelbësore mbeten praktikat më të mira trajnuese dhe zgjedhore të njohura përmes dokumenteve ndërkombëtarë të ODIHR/OSBE dhe Këshillit të Evropës, vlera e të cilave merr vlerë dyfishe në praktikat zgjedhore shqiptare, - si burim referues juridik dhe administrativ, si praktikë e certifikuar e modeleve të cilat ka vullnet politik dhe pritshmëri për ti zbatuar.
- Emërtimi mbetet një çështje që lidhet me funksionet bazë të trajnimit dhe edukimit, dhe me statutin që ky institucion do të ketë në raport me legjislacionin përgjegjës, institucionin e KQZ dhe institucionet apo organizatat e tjera të përfshirë në problematikën zgjedhore.

Roli dhe impakti që Qendra e Trajnimit të vazhduar zgjedhor do të ketë në procesin zgjedhor:

- Vizioni/krijimi i një trupe komisionerësh me nivel profesional;
- Unifikimi i profesionalizmit të anëtarëve të komisioneve të niveleve të dyta dhe të treta vetëm mbi frymën e ligjit, duke certifikuar kështu jo thjesht njohuritë e tyre zgjedhore, por mbi të gjitha duke realizuar instruktimin e tyre në mënyrë të njëjtë. (përcaktim në seksionin "Garancitë procedurale" tek "Kodi i Praktikës së mirë në çështjet zgjedhore", miratuar nga Komisioni i Venecias).
- Fitimi i njohurive ligjore të qëndrueshme, teorike dhe procedurave praktike, duke shmangur informalitetin;
- Reduktimi i fenomeneve negative që janë shfaqur gjatë proceseve zgjedhore në vite;
- Zbeh fenomenin e politizimit të komisionerëve, riorienton kulturalisht për ta parë detyrën si mision administrativ dhe jo politik, ndërgjegjësimiqë forca ndëshkuese të ligjit qëndron mbi partitë;
- Rrit besimin e publikut në procesin zgjedhor.

Kodi Zgjedhor, për sa më sipër, duhet të parashikojë:

- Krijimin e Qendrës së Trajnimit dhe edukimit të vazhduar zgjedhor me status ligjor dhe administrativ të përcaktuar, staf dhe buxhet të sajën;
- Ndryshimet ligjore sa i përket statusi ligjor, buxhetit, strukturës, statutit ligjor për personat e angazhuar, duhet të gjejë qasjet apo të bashkojë praktikat më të mira të sjella në tryezë nga vendet e tjera.

KQZ, me asistencën dhe ekspertizën e partnerëve ndërkombëtarë KE dhe OSCE, ka draftuar ndryshimet e nevojshme ligjore për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit dhe Edukimit Zgjedhor, të cilat do të paraqiten në një material të zgjeruar.

## XI. REKOMANDIME PËR RREGULLIMIN E ÇËSHTJEVE TË TJERA ME QASJE MIRË ADMINISTRIMIN E PROCESIT:

### 1. Rishikimi i afatit ligjor për nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja, përcaktuar në nenin 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor

Numri i konsiderueshëm i KZAZ-ve, përmirësimet ligjore për hapjen e kutisë së materialeve zgjedhore vetëm në rast të mungesës së procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit, janë faktorët kryesorë që ndikojnë në mos zgjatjen në kohë të procesit të numërimit.

Megjithatë, procesi i numërimit të votave, në asnjë proces zgjedhor nuk është përmbjllur në afatin që Kodi Zgjedhor përcakton, jo më vonë se ora 22.00 e ditës së nesërme të votimit. Ky afat nuk arihet të respektohet as në zgjedhjet për Kuvend (ku për çdo QV është vetëm një kuti votimi), dhe zgjat më shumë në kohë në rastin e zgjedhjeve vendore ku do të numërohen dy kuti votimi për çdo qendër votimi. Konkretisht, për zgjedhjet vendore 2015:

**Për kryetarin e bashkisë** procesi i numërimit të votave përfundoi si më poshtë:

|                 |         |        |
|-----------------|---------|--------|
| datë 22.06.2015 | 76 KZAZ | 84.40% |
| datë 23.06.2015 | 12 KZAZ | 13.30% |
| datë 24.06.2015 | 2 KZAZ  | 2.20%  |

**Për këshillin e bashkisë** procesi i numërimit të votave përfundoi si më poshtë:

|                    |         |        |
|--------------------|---------|--------|
| në datë 23.06.2015 | 56 KZAZ | 62.20% |
| në datë 24.06.2015 | 18 KZAZ | 20%    |
| në datë 25.06.2015 | 14 KZAZ | 15.50% |
| në datë 26.06.2015 | 1 KZAZ  | 1%     |
| në datë 28.06.2015 | 1 KZAZ  | 1%     |

Sikundër të dhënat dëshmojnë<sup>1</sup>, edhe në zgjedhjet vendore 2015, edhe vetëm votat për kryetarin e bashkisë nuk u arritën të numërohen në afatin prekluziv që Kodi Zgjedhor përcakton për nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve<sup>2</sup> për ZAZ-në nga KZAZ. Sikundër dihet, procesi i numërimit në zgjedhjet vendore të 2015 ishte i qetë dhe shkoi normalisht pa incidente apo bllokime,<sup>3</sup> pra koha që u desh për përmbjlljen e tij nuk u konsumua për shkak të prishjes së rendit, rivendosjes së tij, apo bllokimeve të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm.

Faktorë që mund të renditen për të argumentuar pse nevojitet/konsumohet kohë përtej afatit ligjor për të përfunduar procesin e numërimit:

- prania një numri shumë të madh të vëzhguesve në VNV;
- presioni që këta vëzhgues ushtrojnë ndaj grupeve të numërimit;

<sup>1</sup> vitin 2013, që ishte vetëm një kuti votimi (pra 1 fletë votimi për tu numëruar), procesi i numërimit u mbyll brenda 7 ditësh, ndërsa në vitin 2011 procesi i numërimit ka zgjatur 14 ditë

<sup>2</sup> tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar; tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve të ZAZ-së për Këshillin Bashkiak

<sup>3</sup> Përfunduar KZAZ nr. 1, ku zvarrit procesi pothuaj deri në bllokim për shkak të mosparaqitjes në detyrë, apo largimit nga detyra me shkak fictive të numëruesve të propozuar nga parti politike të caktuara.

- tejldhodhja e numëruesve pasi shumica e tyre angazhohen edhe si komisionerë në qendrat e votimit;
- disproporcionaliteti i numrit të QV për ZAZ (nga 8 në 124). Në KZAZ-të me numër të madh të QV në juridiksion, mbipopullimi i VNV me vëzhgues, numri i madh i fletëve të votimit për kuti, kushtet jo të përshtatshme të VNV (temperaturat, mungesa e ajrimit) sjellin lodhje jo vetëm të numëruesve por edhe të KZAZ, duke kushtëzuar vijimin e punës me nevojën për pushime të gjata.
- Sjellje jo ligjore të numëruesve, për shkaqe personale apo urdhërime politike.
- Dhe mbi të gjitha, koha fizike që kërkon zbatimi i procedurave ligjore përgjatë numërimit të votave, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së, dalë në bazë e për zbatim të tij. Duke konsideruar hipotetikusht situatën në një KZAZ që ka 60 QV (mesatarja e ngarkesës), se çdo procedurë po shkon në normalitet, pa kontestime, pa mungesa që detyrojnë hapjen e kutive të materialeve të votimit, do të kishim:  
5 tavolina numërimi

Sejcila do të numëronte 12 kuti votimi për kryetar dhe 12 kuti votimi për këshill

Per sejcilën kuti votimi vetëm procedurat e shfaqjes se fleteve në monitor do të kërkonin:

7 sec X 500 fletë = 35 000 sec = 58.3 min = 1 orë

24 kuti X 1 orë= 24 orë.

Vetëm me këtë kohë fizike të kërkuar për shfaqjen në monitor, konsumohet afati ligjor "për nxjerrjen nga KZAZ të tabelës përmbledhëse të rezultateve për ZAZ jo më vonë se ora 22.00 të ditës së nesërme të votimit". Ndërkohë që procedurat e tjera si hapja, shpalosja e fletëve të votimit, numërimi dhe rinumërimi nqs kërkohet, numërimi i votave për seicilin subjekt, tabelimi i rezultateve, nënshkrimi i tabelës dhe plotësimi i vërejtjeve, plotësimi i procesverbalit, procedurat e mbylljes së kutisë, marrja/dërgimi i kutisë në vendin e caktuar, dorëzimi i tabelës së rezultatit dh ekorrigjimi i shifrave nqs shifrat nuk përputhen, janë shumë procedura që kërkojnë kohë tjetër fizike, pa përmendur këtu rastet e kontestimit dhe rivlerësimit.

Për sa më sipër, propozohet

- Kodi Zgjedhor duhet të ndalojë që komisioneri i KQV të emërohet edhe si numërues. Angazhimi i burimeve njerëzore për dy aspekte të procesit, si anëtarë të QV dhe si numërues, puna intensive, me përgjegjësi, në vijueshmëri dhe me orare të zgjatura, padyshim reflekton lodhje dhe rënie të ritmit gjatë procesit të numërimit.
- Afati i përcaktuar në Kodin Zgjedhor për nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ, duhet të rishikohet, përvoja e administruar dëshmon pamundësinë e respektimit të tij.

**2.**Raportet e OSCE/ODHIR, ndër vite evidentojnë faktin e mosrespektimit të kohës së punës nga KZAZ-të, fakt i konstatuar edhe nga KQZ dhe vëzhguesit vendas. KQZ, vlerëson se vijimi

i angazhimit në detyra shtetërore, ndërkohë që emërohen si anëtarë të KZAZ, është një ndër shkaqet kryesore që pamundëson respektimin e orarit të punës nga anëtarët e KZAZ-së. Për shmangien e kësaj pengese, propozohet rregullimi ligjor:

| Është   | Të bëhet   |
|---|--|
| <p><b>Neni 29, pika 3</b></p> <p>“Anëtarët e KZAZ-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZAZ-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj. Për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së.”</p> | <p><b>Neni 29, pika 3</b></p> <p>“Anëtarët e KZAZ-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZAZ-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj. Për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së. <b>Gjatë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre, anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, pezullohen nga detyra kur ata janë nëpunës të administratës publike, dhe për gjatë kësaj kohe i ruhet vendi i punës.”</b></p> |

### 3. Detajimi i disa prej detyrave të KZAZ-së:

| Është  | Propozohet të bëhet:  |
|--|---|
| <p>Neni 33, “ Detyrat e KZAZ-së ” pika b, :<br/>KZAZ-ja kryen këto detyra:</p> <p>b) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi</p> | <p><b>Neni 33, “Detyrat e KZAZ-së” pika b, bëhet :</b></p> <p>KZAZ-ja kryen këto detyra:</p> <p>b) emëron, <b>shkarkon dhe liron</b> kryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi;</p> |
|  | <p><b>Në nenin 33, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:</b></p> <p><b>gj) ndjek dhe informon KQZ-në, për procesin e trajnimit të KQV-ve dhe GNV-ve.</b></p>   |
|  | <p><b>Në nenin 34 “Detyrat e sekretarit të KZAZ-së”, shtohet:</b></p> <p><b>i) Kryen zbardhen e vendimeve të</b></p>  |

|  |  |
|--|--|
|  | <p><b>emërimit të KQV dhe GNV dhe i dërgon ato menjëherë në KQZ.</b></p> <p>j) <b>Informon në çdo rast KQZ-në, në lidhje me lirimimin apo shkarkimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, si dhe dërgon menjëherë kopje të vendimeve.</b></p> |
|  |  |
|  | <p><i>Në nenin 41" Detyrat e sekretarit të KQV-së", shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:</i></p> <p><b>"Transmeton në KQZ dhe/ose në KZAZ, të dhëna për pjesëmarrjen në votime, në orare të përcaktuara me vendim të KQZ-së."</b></p>  |
|  | <p><i>Në fund të pikës 1 të nenit 95 të shtohet një fjali :</i></p> <p><b>"1/1. Anëtari i Komisionit të Qendrës së Votimit, nuk mund të propozohet edhe si anëtar i grupit të numërimit të votave."</b></p>                                |

**4.Kodit Zgjedhor, në nenin 62, veç** të tjerave i vihet detyrë KQZ-së të krijojë dhe përditësojë hartën e zonave të qendrave të votimit por nuk përmendet se nga do ta marrë informacionin për këtë. Më parë kjo ka qënë e përcaktuar në Kod si një detyrim i njesive vendore por me ndryshimet që u bënë në vitin 2012 kjo nuk është përmendur, është shtuar si detyrim i tyre bërja dhe dërgimi në KQZ i planimetrisë të ambjentit të qendrës së votimit. Mendoj se hartimi dhe dërgimi i planimetrisë së ambjentit të mbi 5000 QV-ve është i panevojshëm. Në se ngelet detyrimi i KQZ-së për të përgatitur hartën e zonave të QV-ve, patjetër duhet të shtohet dhe detyrimi i njesive vendore për përgatitjen e këtyre hartave.

**5.Gjithashtu KQZ-ja** për të siguruar informacion të shpejtë e të saktë për QV-të, numrin e zgjedhësve në to dhe vendndodhjen e tyre, kur kryetarët e njesive vendore nuk përmbushin detyrimet e tyre për ta dërguar atë në kohë, mund ta marrë atë nga Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile. Kjo drejtori sic dihet administron elektronikisht gjithë informacionin që kryetarët e njesive dhe zyrat e gjendjes civile përkatëse hedhin në bazën e të dhënave.

Për sa më sipër, propozohen këto ndryshime:

| Është   | Propozohet:   |
|---|---|
| <p><b>Neni 62, pika 5</b></p> <p>“5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.”</p>  | <p><b>Neni 62, pika 5</b></p> <p>“Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, <b>si dhe përgatit hartën zgjedhore të njësisë së qeverisjes vendore sipas përcaktimeve në aktin normativ të KQZ-së.</b>”</p>  |
| <p><b>Neni 62, pika 9</b></p> <p>“9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.”</p> | <p><b>Neni 62, pika 9</b></p> <p>“Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në <b>për numrin e qendrave të votimit, numrin e zgjedhësve në to, vendndodhjen e tyre si dhe dërgon hartën zgjedhore të njësisë së qeverisjes vendore. Njoftimi për vendndodhjen dhe hartën zgjedhore shoqërohet edhe me llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.</b>”</p> |
|   | <p><b>Të shtohet pika 9/1:</b></p> <p>“9.1 Në rast se kompetencat e parashikuara në pikën 9 të këtij neni nuk ushtrohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, detyrimet për numrin e qendrave të votimit, numrin e zgjedhësve në to dhe vendndodhjen e tyre, përmbushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pasi merr njoftimin nga KQZ-ja.</p>  |

**6.Rishikimi i afateve të dorëzimit/kthimit për plotësim/rregjistrimit të listave të kandidatëve për këshillat vendore (Neni 67 pika 1 paragrafi i dytë, dhe 73 pika 1 e Kodit Zgjedhor).**



Neni 67 pika 1, paragrafi i dytë, për zgjedhjet e organeve parashikon që lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 73, pika 1, parashikon si afat të fundit për verifikimin dokumentacionit të kandidatëve në KZAZ 45 ditë para zgjedhjeve. Më tej, në pikën 2 parashikohet që dokumentacioni i kthyer për korrigjime dhe plotësime duhet të depozitohet jo më vonë se 42 ditë në KZAZ. Nga ana e saj KZAZ-ja merr vendim për miratimin dhe refuzimin e dokumentacionit të kandidatëve brenda 48 orëve.

Duke ju referuar këtyre parashikimeve, afati në dispozicion i mbetur për miratimin përfundimtar të fletëve të votimit nga KQZ-ja dhe prodhimin e tyre nga shoqëria prodhuese është 40 ditë.

Por duke marrë në konsideratë parashikimin e nenit 99 pika 1, ku kërkohet që fletët e votimit të dërgohen në KZAZ, 3 ditë para zgjedhjeve duke konsideruar dhe faktin që fletët e votimit para se të shpërndahen duhet të ndahen sipas KZAZ-ve dhe QV-ve, që është një proces voluminoz dhe kërkon të paktën 7 ditë (referuar të gjithë eksperiencave të kaluara), si dhe duke marrë një afat minimal prej 2 ditësh për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit në KQZ, afati real për **prodhimin dhe transportin e fletëve të votimit është vetëm 28 ditë.**

Referuar gjithë eksperiencave të mëparshme, vendimet përfundimtare të KQZ për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e pushtetit vendor (miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit), në masën prej rreth 8 % të tyre, janë ankimuar në Kolegjin Zgjedhor.

Kjo ka sjellë bllokimin e informacionit që KQZ-ja i dërgon shoqërisë prodhuese të fletëve të votimit çka e komplikon dhe çon në vështirësi të shumta këtë proces, pasi referuar nenit 152 pika 2, të drejtën e ankimimit subjektet zgjedhore mund ta ushtrojnë brenda 5 ditëve. Duke marrë një afat optimal prej 3 ditësh për shqyrtimin e këtyre kërkesë padive nga ana e Kolegjit Zgjedhor (referuar nenit 157 pika 1 detyrimi i tij ligjor është 10 ditë) afati real për **prodhimin dhe transportin e këtyre fletë votimeve është vetëm 20 ditë.**

***Në një situatë hipotetike ku të gjithë vendimet e KQZ-së për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit, të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor, referuar parashikimeve të neneve 73 pika 1, 152 pika 2 dhe 157 pika 1, do të jetë praktikisht shumë e vështirë për të mos thënë krejt e pamundur prodhimi i fletëve të votimit.***

Për të bërë të mundur evitimin e kësaj situatë, e cila mund të sjellë edhe moszhvillimin e zgjedhjeve, propozohen këto ndryshime në Kodin Zgjedhor:

- Afati regjistrimit, duke përfshirë të gjithë verifikimet dhe plotësimet e dokumentacionit të kandidatëve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të bëhet jo më vonë se 60 ditë para datës zgjedhjeve (ndryshimi i nenit 67 pika 1, paragrafi i dytë dhe ndryshimi i nenit 73 pika 1 dhe 2, specifikisht për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, për sa i takon afateve kohore të verifikimit të dokumentacionit të kandidatëve jo më vonë se 55 ditë para datës së zgjedhjeve.

**Ose**

- Afatet e ankimit për vendimin e KQZ-së për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit të limitohen deri në 48 orë dhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor për to të merret brenda 48 orëve (ndryshim i nenit 152 pika 2 dhe nenit 157 pika1)

Nqs do të bëhej një nga këto ndryshime, KQZ do të kishte më shumë kohë në dispozicion për prodhimin e fletëve të votimit pasi për këto zgjedhje duhet marrë në konsideratë fakti që për çdo njësi vendore do të ketë dy fletë votimi pra fletët e votimit do të prodhohen në shumë variabla, procesi i prodhimit të fletëve të votimit është kompleks dhe mjaft teknik për të cilin koha në dispozicion është elementi më kryesor.

### **7.Në nenin 94 "Vendodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave " shtohet një pikë:**

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore merr masat logjistike për përshtatjen e ambientit të miratuar nga KQZ, si vend për numërimin e votave.

**8.**Një nga problematikat e shfaqura gjatë procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ishte ajo e lidhur me përcaktimin e partive politike që u lindte e drejta të merrnin pjesë në shortin e organizuar nga KQZ për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave. Përcaktimet e nenit 95, pika 2 (dispozite materiale), dhe nenit 96, pika 1 (dispozitë procedurale), krijojnë hapësira për debate në vendimarrje/interpretime/ankime Në kolegjin Zgjedhor, për faktin se:

- në nenin 95, pika 2, ku parashikohet se: "**anëtari i tretë propozohet nga partitë politike të shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës** që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi";

- nenin 96, pika 1, parashikohet se: "**Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve**, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, **përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare të rregjistruara në zgjedhje** dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. **Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare**".

Në analizë të përmbajtjes së dispozitave sipërcituar, por edhe në referencë të eksperiencës institucionale për zhvillimin e kësaj procedure, KQZ evidenton nevojën e përcaktimit qartësisht të mënyrës së vlerësimit të përkatësisë të partive politike në shumicën parlamentare apo opozitën parlamentare: duhet të vlerësohet pozicionimi faktik i partive politike (pra si janë grupuar për të garuar në zgjedhje), apo pozicionimi i partive politike në zgjedhjet pararendëse?

Gjithashtu, kriteri shtesë për partitë e mazhorancës, përcaktuar në nenin 95 të Kodit Zgjedhor, duke përcaktuar se "... anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse..." duhet të harmonizohet me kriteret e nenit 96 ku përcaktohet vetëm "...listën e partive politike të shumicës parlamentare...", pra partia politike që do të propozojë anëtarin e tretë të GNV, duhet të jetë vetëm parti politike e shumicës parlamentare, apo duhet të vlerësohet dhe kriteri shtesë nëse është apo jo parti qeverisëse.

**9.** Kodi Zgjedhor urdhëron KZAZ-të ti shpërndajnë materialet zgjedhore KQV-ve në juridiksionin, 15 orë para hapjes së votimit. Në shumicën e rasteve ky afat nuk është respektuar, dhe janë vërejtur vonesa të konsiderueshme ku në disa raste materialet e votimit u janë shpërndare komisioneve të qendrave të votimit në orët e vona të natës. Për të shmangur këtë mospërputhje në kohë propozojmë ndryshimin si më poshtë, i cili i jep KQV-së kohën e nevojshme për rregullimin e ambienteve të QV-së, përpara hapjes së votimit.

| <b>Është:</b>  | <b>Propozohet:</b>  |
|--|---|
| <p><b>Neni 100, pika 1, fjalia e parë:</b></p> <p>"KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj".</p> | <p><b>Neni 100, pika 1, fjalia e parë:</b></p> <p><b>"KZAZ-ja, jo më vonë se 18 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj".</b></p> |

**10. Pika 6 e nenit 163 të Kodit Zgjedhor duhet të shfuqizohet, për arsye** se i referohet pikës 3 të nenit 67 që ka rënë nga fuqia. Flitet për shpërndarjen e mandateve për Kuvendin që fitohen nga kryetarë partish politike të regjistruar në më shumë se një listë shumëmemërore.

**11. Për detajimin e rregullave për ruajtjen e dokumentacionit, rekomandohet ndryshime në nenin 178, pika 3,4,5:**

| <b>Është</b>  | <b>Propozohet:</b>  |
|---|---|
| <p><b>Pika 3</b></p> <p>"3. KZAZ-ja mban nga një kopje:</p> <p>a) të dokumentacionit të kandidatëve dhe partive politike që marrin pjesë në zgjedhje;</p> <p>b) të listës së emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KQV-së dhe komisioneve të tjera;</p> <p>c) të listës së qendrave të votimit;</p> | <p><b>Pika 3</b></p> <p>"Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZAZ-ja, komisioni dorëzon në KQZ dokumentacionin origjinal si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së,</li> <li>2. Tabelat e rezultateve për çdo qendër votimi,</li> <li>3. Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së,</li> <li>4. Procesverbalin e Konstatimit të KZAZ-</li> </ol> |

|   |   |
|---|---|
| <p>c) të listave të zgjedhësve për zonën zgjedhore;</p> <p>d) të emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së;</p> <p>dh) të hartës së zonës zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;</p> <p>e) të përshkrimit me shkrim të kufijve të të gjitha zonave të administrimit zgjedhor;</p> <p>ë) të dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, të njoftimeve zyrtare për zgjedhjet të KZAZ-së, të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për çdo qendër votimi dhe të shpalljes përfundimtare të rezultateve;</p> <p>f) të deklaratës së shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve”.</p> | <p>së,</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Regjistrin e Vendimeve të KZAZ-së,</li> <li>6. Regjistrin e Korespondencës të KZAZ-së,</li> <li>7. Listën e emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KQV-së dhe GNV-ve;</li> <li>8. Listën e zgjedhësve për zonën zgjedhore,</li> <li>9. Listën e emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së;</li> <li>10. Listën e vëzhguesve të partive politike të akredituar në KZAZ, KQV dhe GNV.</li> <li>11. Hartën e zonës zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;</li> <li>12. Përshkrimin me shkrim të kufijve të të gjitha zonave të administrimit zgjedhor;</li> <li>13. Dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, të njoftimeve zyrtare për zgjedhjet e KZAZ-ve, të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për kandidatët fitues për kryetar në organet e qeverisjes vendore,</li> <li>14. Deklaratën e shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.</li> </ol> |
| <p><b>Pika 4</b></p> <p>“4 Dokumentet origjinale, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, i dërgohen KQZ-së brenda 3 muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. KQZ-ja mban një kopje dhe ia dërgon dokumentet origjinale Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e kërkuar prej tij dhe brenda 24 muajve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.”</p>   | <p><b>Pika 4</b></p> <p>“4. KQZ mban një kopje të dokumentacionit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni dhe i a dërgon dokumentat origjinale Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e kërkuar prej tij dhe brenda 24 muajve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. ”</p>   |
| <p><b>Pika 5</b></p> <p>“5. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZAZ-ja, komisioni i dërgon KQZ-së, në mënyrën e caktuar prej saj, të gjitha kutitë e vulosura të votimit me procesverbalet e votimit, vulën e komisionit, fletët e votimit të përdorura në zgjedhje, si edhe fletët e</p>   | <p><b>Pika 5</b></p> <p>5. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZAZ-ja komisioni dorëzon në ambjentet e KQZ-së në mënyrën e caktuar prej saj, të gjitha kutitë e vulosura, në të cilat janë fletët e votimit dhe kutitë e vulosura në të cilat janë materialet zgjedhore, të shoqëruara këto me procesverbal të dorëzimit të</p>   |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| votimit të papërdorura”. | materialeve të inventarizuara dhe procesverbal të dorëzimit me numrat e kodeve të sigurisë të kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore.” |
|--------------------------|---|

**12. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve certifikohet, pas përfundimit të shqyrtimit të ankimeve zgjedhore në rrugë administrative dhe Gjyqësore.**

Në zgjedhjet e fundit numri i kërkesave ankimore u rit artificialisht nga disa ankime jo professional, të pambështetura në dispozita ligjore, prova, fakte apo argumenta bindëse. Mjafton të përmendim se një subjekt zgjedhor depozitoi gjithësej 17 kërkesa ankimore, të cilat përshkruanin të njëjtat shkelje, fakte dhe argumenta për 17 zonat zgjedhore rezultati i të cilave ankimohej, ishin (copy past). Numri i madh i partive politike sjell si pasojë vonesë artificiale në procesin ankimor zgjedhor dhe në nxjerrjen e rrezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Rekomandojmë rishikimin e nenit 124 të Kodit Zgjedhor, duke parashikuar depozitimin e ankimit në KQZ, kundrejt një pagese.